

**AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

“S o u r ” SH.P.K

Ortaku i vetem i Shoqërisë, Floris Muho me atësi Besnik dhe amësi Florika, d.tl.16.03.1982, lindur në Tirane, dhe banues në Tiranë rruga Idriz Dollaku, Nd.39, Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar,

bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, mbledhur në Tiranë sot më datë 07.12.2021

mbledhur në Tiranë sot më datë 07.12.2021

VENDOSI:

Të krijojë një shoqëri tregtare dhe për këtë qëllim të hartojë dhe miratojë këtë Akt Themelimi të shoqërisë si më poshtë vijon;

NENI 1
Emri


- 1.1** Shoqëria do të paraqitet në qarkullimin tregtar me emërtimin e saj **“S o u r ”sh.p.k.**
- 1.2** Ndryshimi i emrit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqerise (Ortaku i vetem).

NENI 2
Forma juridike

- 2.1** Shoqëria tregtare **“S o u r ” sh.p.k**, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k).
- 2.2** Shoqëria mund të transformohet në një formë tjeter juridike me vendim të Asamblesë së Përgjithshme (Ortaku i Vetem) sipas përcaktimeve në ligj dhe në Statutin e saj.

NENI 3
Selia

- 3.1** Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën, Rruga "Muhamet Gjollesha", Pallati 69, Shk.3, Kati 4, Njësia Bashkiake Nr.7, Tiranë
- 3.2** Ndryshimi i selisë së shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë (Ortaku i Vetem)



3.3 Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë (Ortaku i Vetëm) shoqëria mund të hapë degë të saj apo Zyra përfaqësimi në qytete të tjera apo dhe jashtë Shqipërisë.

NENI 4
Vula e shoqërisë

4.1 Shoqëria do të ketë vulën e saj.

4.2 Forma e vulës dhe masa e saj do të përcaktohen nga Asambleja e Ortakëve (Ortaku i vetëm) në përputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 5
Objekti i Veprimitarisë

5.1 Shoqëria ka si objekt veprimitaritë që vijojnë më poshtë:

Projektimin dhe realizimin e sistemeve informative,informatike te integruar, telematike, te transmetimit, te proceseve software dhe sherbimeve ne sektorin e trajtimit,perpunimit dhe transmetimit te te dhenave. Studimin,kerkimin, projektimin dhe zhvillimin e produkteve dhe sherbimeve ne fushen e teknologjise se komunikimit te avancuar. Sherbime per konsulence organizimi dhe drejtimi per aplikimin e informatikes dhe telematikes ne proceset e biznesit. Shërbime konsulence, ofrimi i sherbimeve permes nje strukture informatike dhe telekomunikacionit, sherbime keshillimi dhe mbeshtetje ne fushen e marketingut, organizimit. Aktiviteti do te zvillohet ne fushen e promocioneve, sondazheve te ndryshme, konsulenca dhe sherbime sherbine te cilat do te jene brenda dhe jashte vendit, fushata te ndryshme specifike marketing,reklama publicitare etj. Aktivitet ne fushen e marketingut ne Web. Aktivitet ne fushen e tregtise elektronike edhe per llogari te paleve te treta. Ideim, realizim, promovim dhe tregtim i sherbimeve nepermjet telefonit, shtypit elektronik dhe te shkruar dhe terminaleve te kompjuterave; ideimin, realizimi, promovimin dhe operimin e sherbimeve informtaike tele-audio. Ofrimi i sherbimeve te trainimit dhe konsultimit ne ceshjet e telekomunikacionit. Ofrimi, mbeshtetja dhe operimi i sherbimeve te internetit etj.Aktivitetet keshilluese te biznesit ne marketing, publicitet, projektimin, realizimin, menaxhimin. Aktivite te konsultimit per vleresimin e projekteve inovative.Ofrimi i sherbimeve te publicitetit dhe marketingut te te gjitha formave, perfshire ketu edhe publiciteti e marketing duke perdorur metoda inovative, te komunikimit ne distance, te perdorimit te teknologjive te reja, te mediave te reja e cdo menyre tjeter te ligjshme. Mbledhja, e perpunimi e menaxhimi i te dhenave, realizimi i sondazheve e studimeve te ndryshme. Krijimi, mirembajtja dhe menaxhimi i faqeve te internetit per te trete. Aktivitet ne prodhimin e sherbimeve dhe zgjidhjeve informatike. Konceptimi, zhvillimi, implementimi, testimi dhe mirembajtja e sistemeve te teknologjise se informacionit dhe komunikimit. Sherbime te fushen e reklames, studimit te tregut, organizimit te eveneve, marketingut online, sherbimeve te mapping dhe shperndarjes dhe konceptimit, printimit dhe shperndarjes se materialeve publicitare, sherbime administrimi, sherbime informacion dhe teknologji, IT, burime njerezore, menaxhim projekti, konsulence financiare dhe administrimi, konsulence, sherbime marketing, sherbime te ndryshme financiare brenda dhe jashte vendit si dhe konsulence nderkombetare, ndermjetesim. Shoqeria mund te kryeje çfaredo veprimitarie tjeter qe lejohet nga legjislacioni ne fuqi i Republikes se Shqiperise.**5.2 Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çfarëdolloj veprimitarie tjeter të lejuar nga ligji dhe në përputhje me rregullat në fuqi.**

NENI 6
Kohëzgjatja e Shoqërisë

- 6.1** Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje me një afat të pacaktuar.
- 6.2** Shoqëria ka personalitet juridik duke filluar nga momenti i regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 7
Kapitali i Shoqërisë dhe Kuotat

- 7.1** Kapitali i regjistruar i shoqërisë është i përbërë nga kontributi në para i Ortakut të vetëm në vlerën 100.000 lekë.

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë, zoteron një kuotë me vlerë 100.000 lekë (njëqind mijë lekë), e cila përbën 100 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

- 7.2** Kontributet që përbëjnë 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë janë shlyer tërësisht nga Ortaku i Vetëm.

- 7.3** Financimet në formë huaje të bëra nga ortaku do të konsiderohen si hua pa interes.

NENI 8
Organet e Shoqërisë

- 8.1** Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i vetem).
- Administratori

- 8.2** Kompetencat, të drejtat dhe detyrat e këtyre organeve do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

NENI 9
Të drejtat dhe detyrimet e Ortakut të Vetëm

- 9.1** Ortaku jep kontributin e tij në shoqëri në para apo në natyrë, sipas mënyrave dhe afateve të përcaktuara në statut, në të cilën është përcaktuar në mënyrë të detajuar kontributi dhe mënyra e afatet e derdhjes së këtij kontributi në këtë shoqëri. Ortaku i Vetëm përgjigjet ndaj shoqërisë personalisht dhe në mënyrë solidare për dëmet e shkaktuara nga mospërbushja e këtyre detyrimeve apo nga përbushja e tyre përtëj afateve përkatëse. Ortaku i Vetëm mban përgjegjësi për humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

- 9.2** Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë informojnë ortakun për ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare dhe, me kërkesën e tij, duhet t'i vënë në dispozicion llogaritë vjetore, përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare, raportet e organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë.

- 9.3** Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë informojnë Ortakun e Vetëm për periudha njëmujore dhe tremujore për ecurinë e shoqërisë, realizimin e objektivave mujore

dhe tremujore, llogaritë, raportet për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare me partnerët nënkontraktorë, raportet e organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe çdo dokument tjeter të brendshëm të shoqërisë.

9.4 Ortaku i Vetëm i Shoqërisë ka të drejtë të heqi dorë nga Shoqëria dhe mund të shesi kuotën nëpërmjet nënshkrimit të kontratës së shitjes se kuotës, pa qenë nevoja e marrjes së një vendimi paraprak nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë në përputhje me kushtet që i lejon Statutin dhe Ligjin. Heqja dorë nga shoqëria nuk e liron atë nga detyrimet që ka deri në momentin e heqjes dorë dhe nuk e cënon atë në marrjen e të ardhurave që Shoqëria ka siguruar deri në këtë moment.

9.5 Gjatë ushtrimit të të drejtave, Ortaku i Vetëm vepron duke marrë parasysh interesat e shoqërisë. Ortaku i Vetëm respekton detyrimet që burojnë nga Akti i Themelimit dhe Statuti. Ai përpinqet për zhvillimin e aktivitetit të Shoqërisë sipas objektit të veprimtarisë së saj.

NENI 10
Administratori

10.1 Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i vetem). Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

10.2 Administrator i Shoqërisë është Floris Muho, me atësi Besnik dhe amësi Florika, dtl.16.03.1982, lindur në Tirane, dhe banues në Tiranë rruga Idriz Dollaku ,Nd. 39, Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me ID nr. 033941574 dhe nr. personal I20316051E.

10.3 Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i vetëm) mund të emërojë një administrator të dytë me vendim të saj.

NENI 11
Dispozita të fundit

11.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me Aktin e Themelimit, Statutin dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi. Për sa nuk parashikohet në Aktin e Themelimit dhe në Statut, do të zbatohen kryesisht dispozitat e ligjit «Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare», Kodit Civil dhe legjislacionit në fuqi.

NENI 12

12.1 Ky Akt themelimi përpilohet në 5 (pesë) kopje në gjuhën shqipe, dhe u nënshkrua pa vërejtje nga ortaku themelues.

ORTAKU THEMELUES

FLORIS MUHO

